

TRUEN sh.p.k

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

Së Bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

mazars

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR	i-iii
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	4
PASQYRA E PERFORMANCËS	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	6
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	7
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	8-22



Emin Duraku Str. Binjaket Build.
No.5, 1009, Tirana
Albania
Tel: +355 4 2222 889
www.mazars.al

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe ortakët e Shoqërisë Truen Shpk

Opinion me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Truen Shpk (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2020, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjes së përshkruar në bazat për opinion me reserve, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2020, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Baza për opinionin me rezervë

Siç shpaloset në pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto, shoqëria rezulton me një humbje neto në vlerën 25,857 mijë lekë dhe humbja e akumuluar arriti në 140,976 mijë lekë. Raporti korrent është më i ulët se 1, që tregon se me performancën aktuale financiare kompania mund të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj afatshkurtra. Burimi i financimit të kompanisë kanë qenë huatë nga aksionarët dhe banka. Biznesi varet shumë nga kushtet e motit dhe rreshjet e shiut. Në rast të kushteve jo të favorshme të motit që çojnë në një performancë të keqe të hidrocentralit, kompania duhet të gjejë burime të tjera të financimit. Kjo situatë tregon që ekziston një pasiguri materiale që mund të hedh dyshime të mëdha në aftësinë e Kompanisë për të vazhduar me parimin e vijimësisë. Pasqyrat financiare nuk e shpalosin këtë çështje.

Sipas SKK 5 "Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo-materiale", njësia ekonomike duhet të kryejë një vlerësim të faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm në mënyrë që të vlerësojë nëse ka ndonjë indikacion se mund të ndodhë një humbje nga zhvlerësimi.

Nëse identifikohen raste të tilla, njësia ekonomike kërkohet të bëjë një vlerësim të shumës së rikuperueshme të aktiveve të saj. Bazuar në dokumentacionin e marra nga auditimi, ne kemi vërejtur se performanca ekonomike e aktiveve është më e ulët se sa pritej, e cila vlerësohet si tregues se mund të ketë humbje nga zhvlerësimi.

Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2020, njësia ekonomike nuk ka kryer një vlerësim të shumës së rikuperueshme, d.m.th një provë për zhvlerësim. Bazuar në informacionin që kemi marrë, ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë efektin që çdo rregullim i mundshëm që vjen nga zhvlerësimi do të ketë në pasqyrat financiare të Kompanisë. Shuma e zhvlerësimit deri në masën e vlerës së rikuperueshme të tij do të ulet proporcionalisht aktivet dhe kapitalin e pronarit.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Theksim çështje

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin 2.5.3 të pasqyrave financiare, i cili përshkruan vlerësimin e menaxhimit në lidhje me ndikimin aktual dhe potencial të pandemisë së COVID - 19 dhe për arsyen e aplikimit të parimit të vijueshmërisë për përgatitjen e pasqyrave financiare. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të shoqërisë Truen Shpk për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 kanë qënë audituar nga një auditues tjetër, i cili ka shprehur një opinion të pakualifikuar mbi këto pasqyra më 24 qershor 2020.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdijë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënime shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.


Emin Duraku Str., Binjaket Build.,
No.5, 1013, Tirana, Albania
NUIB: K32123006W

Diana Ylli (Golemi)

Auditues Ligjor

30 qershor 2021

TRUEN SHPK

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2020

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	1,529,634	204,958
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	3,464,722	10,269,777
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	2,736,861	1,768,512
Kapital i nënshkruar i papaguar	7	1,020,000	1,020,000
Totali i aktiveve afatshkurtra		8,751,217	13,263,247
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	8	146,395	189,856
Aktive afatgjata jomateriale	9	270,088,914	283,266,986
Totali i aktiveve afatgjata		270,235,309	283,456,842
Totali i aktiveve		278,986,526	296,720,089
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	10	33,475,277	22,554,751
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	11	92,658,590	98,809,511
Detyrime tatimore	12	183,042	606,415
Të tjera detyrime	13	1,137,746	1,805,401
Totali i detyrimeve afatshkurtra		127,454,655	123,776,078
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	14	269,919,944	269,919,944
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	15	4,444,978	-
Totali i detyrimeve afatgjata		274,364,922	269,919,944
Totali i detyrimeve		401,819,577	393,696,022
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar	16	44,000,000	44,000,000
Fitime të mbartura		(140,975,933)	(122,604,739)
Fitimi i ushtrimit	24	(25,857,118)	(18,371,194)
Totali i kapitalit		(122,833,051)	(96,975,933)
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		278,986,526	296,720,089

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

TRUEN SHPK

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Performancës

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	17	24,492,193	33,275,342
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	18	1,654,561	-
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime	19	(595,474)	(138,328)
Lënda e parë, materiale të			
1) konsumueshme dhe shpenzime të tjera		(595,474)	(138,328)
2) Të tjera shpenzime		-	-
Shpenzime të personelit	20	(4,084,339)	(4,260,115)
1) Paga dhe shpërblime		(4,025,318)	(4,188,902)
Shpenzime të sigurimeve			
2) shoqërore/shëndetësore		(59,021)	(71,213)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	21	(13,221,834)	(13,217,498)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	22	(15,763,411)	(16,642,410)
Të ardhura të tjera		-	-
Interesa të arkëtueshme dhe të			
1) ardhura të tjera të ngjashme		-	-
Shpenzime financiare	23	(18,338,814)	(17,388,185)
Shpenzime interesi dhe shpenzime të			
1) ngjashme		(18,338,814)	(17,788,474)
2) Shpenzime të tjera financiare		-	400,289
Fitimi/humbja para tatimit	24	(25,857,118)	(18,371,194)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		-	-
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		-	-
Fitimi/humbja e vitit	24	(25,857,118)	(18,371,194)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(25,857,118)	(18,371,194)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

TRUEN SHPK

(Vlerat janë në Lek)



Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

	Kapitali i nënshkruar	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2019	44,000,000	(136,933,313)	14,328,574	(78,604,739)
Transferim ne Fitime/(Humbje) te mbartura		14,328,574	(14,328,574)	-
Fitimi / Humbja e vitit			(18,371,194)	(18,371,194)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	44,000,000	(122,604,739)	(18,371,194)	(96,975,933)
Transferim ne Fitime/(Humbje) te mbartura		(18,371,194)	18,371,194	-
Fitimi / Humbja e vitit			(25,857,118)	(25,857,118)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	44,000,000	(140,975,933)	(25,857,118)	(122,833,051)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 janë aprovuar nga administratori i TRUEN sh.p.k më 18/06 2021 dhe janë firmosur si më poshtë:


Idlir Themeli
 Hartues i Pasqyrave Financiare



Z. Julien Gerard Emile Louis Roche
 Administrator


TRUEN SHPK

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitim / Humbja e vitit	23	(25,857,118)	(18,371,194)
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:			
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	20	13,221,834	13,217,498
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:			
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	5,6,7	5,836,706	11,539,137
Rënie/(rritje) në parapagime dhe shpenzime të shtyra	9,10,11,1		
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	2	3,589,565	(13,860,368)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		(3,209,013)	(7,474,927)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit			
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	8	(301)	301
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		(301)	301
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
Ripagim/ të hyrat neto nga huatë afatgjata	13,14	4,444,978	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		4,444,978	-
Ndryshimi neto i mjeteve monetare			
Mjetet monetare në fillim të periudhës		1,235,664	(7,474,626)
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		204,958	7,679,584
		89,012	-
Mjetet monetare në fund të periudhës	4	1,529,634	204,958

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

TRUEN SHPK

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "TRUEN" sh.p.k është regjistruar pranë QKR me datë 13/04/2012 me NIPT L21617015E. Organizimi dhe funksionimi i saj rregullohet sipas ligjit nr. 9901 dt 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".

Veprimtaria kryesore tregtare e Shoqërisë është planifikimi, projektimi, financimi, ndertimi, testimi, transferimi, funksionimi dhe mirembajtja e nje Hidrocentrali te ndertuar ne lumin Truen, ne Rrethin e Pukes, ne Shqiperi ("Projekti Truen"), si dhe shitjen e energjise se prodhuar prej tij.

Truen shpk është liçensuar nga ERE për prodhimin dhe tregëtimin e energjisë elektrike.

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 44,000,000 lekë i cili zotërohet nga aksionerët e shoqërisë.

Administrator i Shoqërisë është Z. Julien Gerald Emile Louis Roche.

Selia qendrore e saj është në adresen : Blvd. Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Nr. 1, Kati 7, Tiranë.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.5.3. Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë.

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, (zhvlerësimi i aktiveve, vlera e drejtë, etj.) dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit.

TRUEN SHPK

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)

Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
EUR/Lek	123.70	121.77
USD/ Lek	100.84	108.64

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

TRUEN SHPK

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivët financiarë të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

TRUEN SHPK

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.3. Inventarët (vazhdim)

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.4. Aktive afatgjata materiale

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyrash	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Të tjera AAM	Vlera e mbetur	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

iv. Ç'regjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.5. Aktivët Afatgjatë Jomateriale

Një aktiv jo-material njihet nëqoftëse, e vetëm nëqoftëse:

është e mundur që përfitimet e pritshme ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktiv do të rrjedhin tek njësi ekonomike; dhe kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri.

Një njësi ekonomike vlerëson mundësinë e përfitimeve të pritshme ekonomike në të ardhmen duke përdorur supozime të arsyeshme dhe të mbështetura që përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të drejtimit të kompletit të kushteve ekonomike që do të ekzistojnë gjatë jetës së dobishme të aktivit.

Njësi ekonomike përdor gjykimin për të vlerësuar shkallën e sigurisë bashkëngjitur flukseve të përfitimeve ekonomike në të ardhmen që i atribuohen përdorimit të aktivit mbi bazën e evidencës së disponueshme në kohën e njohjes fillestare, duke i dhënë më shumë rëndësi evidencës nga të tretët.

Një aktiv jo-material matet fillimisht me koston.

Mbajtja e mëposhme

Mbas njohjes fillestare, një aktiv jo-material mbartet me koston e tij minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvelrësimi.

Aktivët jo-materiale të krijuara nga marrëveshja koncesionare janë amortizuar në bazë të periudhës koncesionare.

Aktivët e tjera jo-materiale amortizohen me normën 15% mbi koston historike.

3.5.1 Marrëveshjet Koncesionare

Një marrëveshje koncesionare e shërbimeve është një marrëveshje ku një qeveri ose një organ tjetër i sektorit publik (konçesiondhënësi) kontraktin një operator privat për të ndërtuar (ose përmirësuar), përdorur dhe mirëmbajtur aktivët e infrastrukturës së konçesiondhënësit si rrugë, ura, tunele, aeroporte, rrjete të shpërndarjes së energjisë, burgje apo spitale. Në këto marrëveshje, konçesiondhënësi kontrollon ose rregullon çfarë shërbimesh duhet të ofrojë operatori duke përdorur aktivët, kujt duhet t'ia sigurojë dhe me çfarë çmimi, dhe gjithashtu kontrollon çdo interes të mbetur domethënësisht në aktive në fund të afatit të marrëveshjes.

Shoqëria ka njohur aktivët e krijuara nga marrëveshja koncesionare sipas modelit të Aktivit Jomaterial.

Operatori duhet të njohë një aktiv jo-material në masën që i jep atij të drejtën (licensën) për t'ia tarifuar përdoruesve të shërbimit publik. Operatori duhet fillimisht të masë aktivin jo-material me vlerën e drejtë. Më tej për kontabilizimin e aktivit jomaterial, operatori duhet të zbatojë kërkesat e SKK5 Aktivët afatgjatë materiale dhe aktivët afatgjatë jomateriale.

3.6. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Shoqëria i njeh të ardhurat kur transmeton energjinë.

TRUEN SHPK

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.7. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.8. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka qira operative.

3.9. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.10. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cillin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15% (2020: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimit të shtyrë mbi fitimin.

3.11. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

TRUEN SHPK**Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë në Lek)***3. Politikat Kontabël (vazhdim)****3.12. Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.13. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.14. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Mjete monetare në bankë	1,529,634	156,104
Në lekë	1,340,686	151,355
Në monedhë të huaj	188,948	4,749
Mjete monetare në arkë	-	48,854
	<u>1,529,634</u>	<u>204,958</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Klientë	3,464,722	10,269,777
	<u>3,464,722</u>	<u>10,269,777</u>

TRUEN SHPK

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
TVSH për t'u rimbursuar	371,939	53,581
Tatimi mbi fitimin	2,273,413	1,704,931
Parapagime	31,859	-
Shpenzime te shtyra	59,650	10,000
	2,736,861	1,768,512

7. Kapitali i nënshkruar i papaguar

Kapitali i nënshkruar i papaguar më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Kapitali i nënshkruar i paderdhur CNR	1,020,000	1,020,000
	1,020,000	1,020,000

8. Aktive Afatgjate Materiale

	Mobilje dhe orendi	Pajisje informatike	Totali
Kosto			
Gjendja më 1 janar 2019	244,417	462,552	706,969
Shtesa			
Nxjerrje jashtë përdorimit			
Gjendja më 31 dhjetor 2019	244,417	462,552	706,969
Shtesa			
Nxjerrje jashtë përdorimit			
Gjendja më 31 dhjetor 2020	244,417	462,552	706,969
Amortizimi i akumuluar			
Gjendja më 1 janar 2019	(144,303)	(316,198)	(460,501)
Amortizimi i vitit	(20,023)	(36,589)	(56,611)
Nxjerrje jashtë përdorimit			
Gjendja më 31 dhjetor 2019	(164,326)	(352,787)	(517,113)
Amortizimi i vitit	(16,018)	(27,443)	(43,461)
Nxjerrje jashtë përdorimit			
Gjendja më 31 dhjetor 2020	(180,344)	(380,230)	(560,574)
Vlera neto kontabël			
Gjendja më 31 dhjetor 2019	80,091	109,766	189,856
Gjendja më 31 dhjetor 2020	64,073	82,322	146,395

TRUEN SHPK

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

9. Aktive Afatgjate Jomateriale

	Aktive të krjuara sipas marrëveshjes konçesionare	Të tjera jomateriale	Total
<i>Kosto</i>			
Gjendja më 1 janar 2019	346,972,774	2,545,761	349,518,535
Shtesa			
Nxjerrje jashtë përdorimit			
Gjendja më 31 dhjetor 2019	346,972,774	2,545,761	349,518,535
Shtesa			
Nxjerrje jashtë përdorimit			
Gjendja më 31 dhjetor 2020	346,972,774	2,545,761	349,518,535
<i>Amortizimi i akumuluar</i>			
Gjendja më 1 janar 2019	(51,873,503)	(1,216,858)	(53,090,361)
Amortizimi i vitit	(12,961,550)	(199,638)	(13,161,189)
Nxjerrje jashtë përdorimit			
Gjendja më 31 dhjetor 2019	(64,835,053)	(1,416,496)	(66,251,549)
Amortizimi i vitit	(13,008,940)	(169,132)	(13,178,072)
Nxjerrje jashtë përdorimit			
Gjendja më 31 dhjetor 2020	(77,843,993)	(1,585,628)	(79,429,621)
<i>Vlera neto kontabël</i>			
Gjendja më 31 dhjetor 2019	282,137,721	1,129,265	283,266,986
Gjendja më 31 dhjetor 2020	269,128,781	960,133	270,088,914

10. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Llogari të pagueshme tregtare	33,444,352	22,554,751
Furnitorë për fatura të pambërritura	30,925	
	33,475,277	22,554,751

TRUEN SHPK

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

11. Llogari të pagueshme afatshkurtra ndaj palëve të lidhura

Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Detyrime tregtare ndaj palëve të lidhura (Wenerg)	87,143,524	71,768,140
Detyrime tregtare ndaj palëve të lidhura (Ylliad)	5,515,066	21,218,180
Detyrimi ndaj te treteve pale e lidhur		1,388,275
Detyrime të tjera ndaj palëve të lidhura (Julian Roche)	-	4,434,916
	<u>92,658,590</u>	<u>98,809,511</u>

12. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
TVSH për t'u paguar	-	459,449
Detyrime për Sigurime Shoqërore & Shëndetsore	9,396	22,184
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	162,513	106,287
Detyrim per tatimin ne burim	11,133	18,495
	<u>183,042</u>	<u>606,415</u>

13. tjera detyrime

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 për Shoqërinë vijojnë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Interesa pasive te llogaritura	471,634	
Detyrime ndaj punonjësve	666,112	1,805,401
	<u>1,137,746</u>	<u>1,805,401</u>

14. Hua afatgjata

Huaja afatgjatë e marrë nga banka OTP më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Hua afatgjata nga Bankat	269,919,944	269,919,944
	<u>269,919,944</u>	<u>269,919,944</u>

Interes + Principal	Interes	Tarife	Gjobe	Principal	Interes I pagueshem
217,105,343ALL	124,045,066ALL	4,638,172ALL	491,381ALL	93,060,278ALL	41,466,830ALL

TRUEN SHPK

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

15. Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura, afatgjata

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura përfaqësojnë vlerën e marrë hua nga Shoqëria mëmë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura AGJ	4,444,978	
	<u>4,444,978</u>	<u>-</u>

16. Kapitali

Vlera e kapitalit më 31 dhjetor 2020 është 44,000,000 Lekë i zotëruar nga aksionerët Ylliad dhe CN' AIR. 49% e aksioneve zotërohen nga Ylliad dhe 51% e aksioneve zotërohen nga CN' AIR.

Humbjet e mbartura më 31 dhjetor 2020 janë (25,857,118) Lekë.

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Numri i pjesëve	4,400	4,400
Vlera nominale (në LEK)	10,000	10,000
	<u>44,000,000</u>	<u>44,000,000</u>

17. Te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Të ardhura nga shitja e energjise	24,377,236	33,275,342
Te ardhura nga sherbime te tjera	114,957	-
	<u>24,492,193</u>	<u>33,275,342</u>

Truen Shpk është licencuar nga ERE për prodhimin dhe tregjetimin e energjise elektrike. Truen Shpk nuk ka realizuar të ardhura nga tregjetimi gjatë këtij viti.

18. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera nga shfrytëzimi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Humbje nga azhurnimi i Arkes/Bankes	1,197,813	-
Fitime nga azhurnimi i Arkes/Bankes	456,748	-
	<u>1,654,561</u>	<u>-</u>

TRUEN SHPK

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

19. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Shpenzimet për lëndë të para dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Sherbime menaxhimi Ylliad	-	138,329
Tatime të tjera (Tarife koncesionare)	595,474	-
	595,474	138,328

20. Shpenzime personeli

Shpenzime personeli për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Paga dhe shpërblime	4,025,318	4,188,902
Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore	59,021	71,213
	4,084,339	4,260,115

21. Shpenzime konsumi dhe amortizimit

Shpenzime konsumi dhe amortizimi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	13,221,834	13,217,498
	13,221,834	13,217,498

TRUEN SHPK

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

22. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Gjoha dhe dëmshpërblime	226,800	228,454
Sherbime menaxhimi Ylliad	12,430,468	12,569,934
Energji për administratën (vetefurnizim)	114,957	138,329
Qira zyra	1,129,981	1,675,512
Sherbime ruajtje dhe sigurie	536,850	596,500
Sherbime kontabiliteti	372,803	520,353
Sherbime noteriale	3,200	-
Sherbime auditim	120,000	-
Shpenzime Licensimi	209,453	-
Shpenzime për shërbimet bankare	36,493	55,207
Taksa dhe tarifa vendore	324,350	101,000
Taksa e Regjistrimit	229,715	62,130
Te tjera	28,341	658,298
Dieta	-	36,694
	<u>15,763,411</u>	<u>16,642,410</u>

23. Shpenzime interesi neto dhe shpenzime të ngjashme

Shpenzimet e interesit neto detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime për interesa	18,338,814	(17,788,474)
Shpenzime te tjera financiare	-	400,289
	<u>18,338,814</u>	<u>(17,388,185)</u>

24. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Fitimi para tatimit	(25,857,118)	(18,371,194)
Total shpenzime të panjohura	18,602,720	18,016,928
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	(7,254,398)	(354,266)
Tatim fitimi @15%	-	-
Fitimi Neto	<u>(25,857,118)</u>	<u>(18,371,194)</u>

TRUEN SHPK**Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë në Lek)***25. Mardhëniet me palët e lidhura**

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Ylliad Shpk		37,327,221		43,340,945
Wenerg Sha		87,143,524		71,768,140
JULIEN-GERARD	-	1,389,238		4,195,923
EMILE LOUIS ROCHE				
CNR	1,020,000	4,444,978	1,020,000	4,434,916
	1,020,000	130,304,960	1,020,000	123,739,925

Transaksionet me palët e lidhura më 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	
	Shitje	Blerje
Ylliad shpk	-	15,240,350
Wenerg Sha	-	-
Julien Roche		1,038,594
	-	16,278,944

26. Angazhime dhe pasiguri*Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2020 shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

27. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje tjetër pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.